



Pranimi / Dorezimi Pamirjen/Protokoll Received/Deliverty		09.06.2021		1 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSHK	2996/2021		114		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.436/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2024/20 të datës 20.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.91/2020 të datës 16.03.2020 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër Vendimit me numër KA.nr.06/2020 të datës 14.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 09.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.91/2020 e datës 16.03.2020, e parashtruar nga ankuesja.
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me numër KA.Nr.06/2020 i datës 14.02.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesja Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datë 16.03.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 678/2020 të regjistruar me numër A.nr.91/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër KA.Nr.06/2020 të datës 14.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.05.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 21.05.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje të ankesës, ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më Aktgjykimin A.Nr.2024/20 të datës 20.05.2021, ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 16.03.2020 të parashtruar nga ankuesi

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 16.03.2020 me numër protokolli 678/2020 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.Nr.06/2020 të datës 14.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e datës 10.02.2020 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; E-mailin e datës 06.02.2020 nga Formularin e Divizionit të Komisioneve Mjekësore të datës 01.10.2019; Njoftimin e datës 07.03.2019 nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës; Raportin Specialitik të datës 25.02.2019; Raport Konziliar i datës 21.11.2018; Fletëlëshimin i datë 05.11.2018; Kërkesë për zvogëlim të orarit të punës dhe ndërrim të vendit të punës të datës 15.03.2019 nga ankuesja për Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Raportin nga Poliklinika Endomedica të datës 05.03.2020 dhe 27.02.2020; Raportin mjekësor të datës 01.02.2020; Procesverbalin e datës 13.02.2020; Raportin nga konsulta të datës 20.11.2018; Raportin nga TIRANA LAB të datës 31.10.2018; Raportin Specialitik të datës 27.02.2019; Raportin e datës 26.11.2018 me EKG; Shkresën njoftuese të datës 03.08.2018 nga ankuesja për Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën për ndërrim të vendin të punës dhe orar të shkurtuar të punës për shkak të gjendjes shëndetësore e datës 01.04.2019 nga ankuesja për Administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën për zvogëlim të orarit të punës dhe ndërrim të vendit të punës e datës 30.11.2018 nga ankuesja për Institutin e Mjekësisë së Punës; Komunikimet me e-mail të \_\_\_\_\_ ne \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ dhe Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2020; Njoftimin e datës 15.05.2020 për ankuesen; Kërkesën e datës 01.03.2021 nga ankuesja dhe Aktgjykimin A.nr.2024/20 të datës 19.05.2021 Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe pas analizimit të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton së Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nëpërmjet e-mailit të datës 06.02.2020, ka njoftuar zyrtaret përfshirë edhe ankuesen e se nga data 07.02.2020 të vazhdojnë punën ne pajtim me Rregulloren Nr.05/2010 për Orarit të Punës, me arsyetimin se të njëjtit punojnë me orar të shkurtuar të punës bazuar vetëm në vlerësimet mjekësore pa ndonjë vendim të organit të punësimit.

Ankuesja pas këtij njoftimi, me datë 10.02.2020 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky i fundit me Vendimin me numër KA.nr.06/2020 të datës 10.02.2020, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

E pakënaqur me Vendimin me numër KA.nr.06/2020 të datës 14.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesja brenda afit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor se vendimi i atakuar nuk është i drejtë sepse ankuesja posedon dokumentacionin mjekësor, respektivisht aprovim nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë si dhe nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e më të cilat i është miratuar kërkesa për shkurtim të orarit të punës dhe ndërrim të vendit të punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.31/2012 për Procedurat e Përkujdesjes për Nëpunësit Civil për Shkak të Paaftësisë Fizike apo Mendore ose Problemeve Shëndetësore përkatësisht nenin 2 i cili ka përcaktuar se: *Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për nëpunësit civilë në rastet e paaftësisë fizike apo mendore, ose problemeve shëndetësore të shkaktuara gjatë kryerjes së detyrave zyrtare*, ndërsa neni 7 po i të njëjtës Rregulle ka përcaktuar se: *Nëpunësi civil të cilit i është zvogëluar aftësia e përhershme për punë e shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare e që nuk e pengon ushtrimin e detyrave tjera sipas konstatimit të Komisioni Mjekësor të përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, duhet t'i mundësohet: 1.1. transferimi/ricaktimi në vend tjetër adekuat sipas aftësisë së mbetur për punë dhe sipas përgatitjes së tij profesionale, brenda institucionit ku ai punon. 1.2. transferimi/ricaktim në ndonjë vend tjetër të punës brenda institucioneve të Shërbimit Civil. 1.3. të punoj me orar të shkurtuar të punës në vendin e tij të punës apo vend tjetër sipas aftësisë së mbetur për punë, e si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil në rast të paaftësisë së përkohshme të shkaktuar gjatë ushtrimet të detyrës se tij të punës dhe të konstatuar nga Komisioni kompetent mjekësor, i njihet e drejta e përkujdesjes gjegjësisht e drejta e ndërrimit respektivisht e transferimit në një vend tjetër pune brenda institucionit ku ai punon apo në institucionit tjetër të shërbimit civil duke pas parasysh përshtatshmërinë me aftësinë e tij të punës dhe përgatitjen profesionale, si dhe e drejta e punës me orar të shkurtuar në vendin e tij të punës apo në ndonjë vend tjetër të punës po në përshtatshme me aftësitë e tij të mbetura të punës.*

Bazuar në nenin 3 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores Nr.31/2012 për Procedurat e Përkujdesjes për Nëpunësit Civil për Shkak të Paaftësisë Fizike apo Mendore ose Problemeve Shëndetësore, me paaftësi të pjesshme fizike apo mendore ose probleme shëndetësore të shkaktuara si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare – nënkuptohet: *paaftësia e pjesshme për shkak të dëmtimeve të funksioneve fizike dhe psikike të konstatuar nga Komisioni Mjekësor, në pajtim me parimet e definuar sipas klasifikimit ndërkombëtar për funksione trupore, invaliditetet dhe shëndet, të cila janë shkaktuar te nëpunësi civil, si rezultat i lëndimit apo sëmundjes gjatë kryerjes së detyrës zyrtare; ndërsa përkujdesja nënkupton: kompensimin material për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, apo përshtatje të kushteve dhe ambientit të punës, në rast të transferimit/ricaktimit në vend tjetër të punës, ndaj nëpunësit civil për paaftësi të konstatuar nga Komisioni Mjekësor me vendim të plotfuqishëm, që është shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të nëpunësit civil.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si me larte si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka gjetur se Komisioni Mjekësor me Formularin e datës 01.10.2019, të Divizionit të Komisioneve Mjekësore të Ministrisë së Punëve dhe Mirëqenies Sociale, ka konstatuar se sëmundjet dhe ndryshimet anatomike-funksionale të pacientit-ankueses nuk janë pasojë e lëndimit në punë, dhe nuk saktëson asnjë lloj të paaftësisë së ankueses, përkatësisht Komisioni ka evidentuar lloj të paaftësisë fizike, mendore dhe sensitive, duke rekomanduar se e njëjta është e aftë



për punë por me orar të shkurtuar/4 orë. Andaj, meqenëse Komisioni kompetent Mjekësor nuk ka konstatuar paaftësi të përkohshme të ankuseses dhe të shkaktuar gjatë ushtrimit të detyrave të punës, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër KA.nr.06/2020 të datës 14.02.2020, ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.436/2021

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuseses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

